Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republikc of Kosovo

Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

**DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRSTRUKTURË DHE BANIM**

# RAPORTI VJETOR I PUNËS

# 2015

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republikc of Kosovo**

**Komuna e Gjilanit**
**Opština Gnjilane**
**Municipality of Gjilan**
**Gilan Belediyesi**

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE. INFRASTRUKTURË DHE BANIM

| | |
|---|---|
| Referencë: | Sh. z nr.__________ |
| Për/Za/To: | **z. Lutfi Haziri** - Kryetar i Komunës |
| CC: | |
| Përmes/Preko/Throgh: | |
| Nga/Od/From: | **z. Naser Korça –** Drejtor i DSHPIB-së |
| Tema/Subjekat/ Subjekct: | **RAPORTI i Vjetorë i punës-** 2015 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i Zyrës: Br. Kancelarije: Room No: | 8 | Lokacioni: Lokacija: Extencion: | **DSHPIB** | Data: Datum: Date: | **12.01.2016** |

| | |
|---|---|
| Për aktivitet/Za aktivnost/Foraction/ | |
| Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested/ | |
| Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Note and retur/ | |
| **Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/** | **X** |
| Afati/ Rok/Deadline/ | |

**I nderuar z. Kryetar!**

Bazuar në obligimet e drejtorisë dhe kompetencat e saj, Ligjet e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e ndryshme administrative si dhe në dispozitat ligjore të aplikueshme të cilat i përkasin fushëveprimtarisë së vet **- Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim** konform buxhetit të projektuar-planifikuar, objektiv të vetin ka pasur arritjen e këtyre objektivave:

- Ngritja e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Kompletimi dhe harmonizimi i infrastrukturës ligjore-akteve normative nga fushëveprimi i Drejtorisë, me Ligjet dhe Rregulloret në fuqi;
- Realizimin e sa më tepër projekteve me interes për qytetarët dhe Komunën në përgjithësi;
- Mirëmbajtja e projekteve të realizuara që kanë të bëjnë me shërbimet publike-infrastrukturën;
- Identifikimi i problemeve të infrastrukturës në përgjithësi dhe inicimi, ofrimi i zgjidhjeve të mundshme;
- Krijimi i një ambienti më të sigurt dhe më të shëndoshë për qytetarët.

- **PROJEKTET KAPITALE - sipas projekt kodit investime kapitale**

1. “Mirëmbajtja verore e rrugëve” (Sanimi i rrugëve trotuareve dhe parqeve), projekt me rëndësi për Komunën e Gjilanit në kuadër të kod projektit. Drejtoria në fillim të muajit Mars ka iniciuar kërkesën për aktivitetet e prokurimit të cilën e ka aprovuar Kryetari i komunës sipas detyrës zyrtare. Me datën 09.06.2015 kemi vazhduar me mbylljen gropave sipas prioritetit së pari në rrugët kryesore nga kompania “TALI si dhe është planifikuar dhenja e shtresave

**Rrugët e sanuara: 15,076.27 m²**

**Shtresat e asfaltit 13,922.85 m²**

2. “Pastrimi i rrugëve mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave të gjelbërua” - kontraktues “Eco-Higjiena” - Gjilan. Realizohet në kuadër të kod projektit. Punët janë duke u zhvilluar sipas kontratës është duke u bërë krasitja, mbjellja e trëndafilave, barit, spërkatja dhe larja e rrugëve.
    - Si informatë shtesë nga ‘Praktikat e mira në komuna-BACON është fituar vendi i parë në Kosovë për menaxhim të hapësirave të gjelbërua si rezultat është fituar Shpërblimi, më pas është realizuar projekti “Hapja e pusit në parkun ILIRIA te shkolla Abaz Ajeti” dhe sistemi i uitjesë te parku “Bulevadi i Pavarësisë” në qendër të qytetit.

3. “Sinjalizimi vertikal – horizontal, numërizimi i objekteve” - kontraktues “Viva – Print” nga Gjilani. Punët janë realizuar sipas dinamikës së projektit dhe ka skaduar kontrata në muajin Prill, është bërë kërkesa për shpalljen e tenderit nga zyra e prokurimit, procedura janë proces.

4. “Sanimi i ndriçimit publik” në fshatrat e komunës së Gjilanit. Kontraktues “Elektring” nga Ferizaj
Është kryer ndriçimi publik në gjitha fshatrat e është duke u vazhduar mirmbatja nga Kontraktori ( ndrimi i poqave nga te ato me shpenzime të larta në poqa ekonomike)
Vlen të theksohet se DSHPIB e ka nxjerrurë një urdhëresë për vendosjes se një releje kohore për kontrollin e shpenzimeve elektrike nga ora 24.00 të ndërpritet.

5. “Sanimi i ndriçimit publik” në qytetin Gjilanit. Kontraktues “Viva Print” nga Gjilani.
Është vazhduar me mirëmbajtje dhe zgjerim të rrjetit të ndriçimit publik në rrugët e qytetit, punët janë duke u zhvilluar sipas kontratës një ashtu edhe qytet është duke u bër (ndrimi i poqave nga te ato me shpenzime të larta në poqa ekonomike ) deri më tani është punuarë

**= 622 cope TN (trupa ndriçues)**
**= 41.255 m` Kabllo**
**= 400 ndërrim poqave**

6.“Rrugët e rendit të tretë”- kontraktues “Bass Comm” nga Gjilani. Janë kryer disa rrugë në lagjet e qytetit si dhe nëpër fshatrat e komunës. Është bërë hapja , rrafshimi si dhe trasimi dhe shtruarja e rrugëve me zhavorr, gjithsej janë realizuar sipas planit dinamik dhe kontrtaës :

- **72 rrugë nëpër fshatra**
- **Rreth 82 km rrugë të renovuara dhe të shtruara**

7. Në kuadër të projektit "Projekte të Vogla" nga kompania Elbau janë realizuar këto punime"

- **Gjithsej kanalizim -- 1576.7 m’**
- **Gjithsej Kubëza --- 2853 m$^2$**

7. Projektin e Mirmbatjesë Dimërore dhe Verore është dorëzuar tenderi në zyrën prokurorimit është shpallur për vitin 2015/2016, Si dhe është lidhur kontrata

➢ **PROJEKTET TJERA**

1. “Bartja e automjeteve me merimangë” - Kontraktues “Auto Buli” Gjilan. Punët janë duke u zhvilluar sipas kontratës.
2. “Ofrimi i shërbimit të varrimit” - Kontraktues “Bereqeti” Gjilan. Punët janë realizuara sipas kontratës ,mirëpo kontrata ka skaduar për momentin, është në zyrën e prokurimit në procedurë të lidhjes së kontratës

**1. TE HYRAT NE DREJTORINE PER SHERBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURE DHE BANIM /2015 periudha Janar- dhjetor**

| Nr. | Taksë rrugore(10 dhe 20) € ShP 9 01 | Taksë për automjetin e tërhequr ShP 9 02 | Taksë për ndërhyrje në infrastrukturë ShP 9 03 | Taksë për shfrytëzimin e hapësirës publike ShP 9 04 | Taksë shitja e banesave në pronësi publike ShP9 05 | Gjobat në trafik për /2015 | Gjobat në trafik për mes gjyk.për 2015 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Totali | **165,600 .00€** | **22,126.00€** | **10,786.45€** | **90,641.43€** | **352.00€** | **250.00€** | **252,456.00€** |

3. **PERSONAT E VDEKUR**

| **NR.** | **Muaji** | **Nr. i personave** | vërejtje |
|---|---|---|---|
| 1 | Janar - dhjetor | **694** | |

4. **AUTOPARKU-TERHEQJA DHE VENDQENDRIMI**

| **Nr** | **Periudha e tërheqjes** | **Automjetet e Tërhequra** | **Automjetet të Liruara** | **Automjetet e mbetura** |
|---|---|---|---|---|
| | **Periudha para 2015** | | | **55** |
| | **Janar – dhjetor 2015** | | **690** | **Autoparku i komunës - 15**<br>**Autoparku i PK.-së- 15** |
| | **TOTALI** | **720** | **690** | **30** |

Automjetet në autoparkun e Komunës dhe në atë të Policisë së Kosovës kanë mbetur për shkak të proceduarve gjyqësore.

5. **Raporti detal i inspektorëve te komunikacionit dhe shërbimeve publike**

| **Nr.** | Numri i inspektimeve | Numri i procesverbaleve | Numri i kundërvajtjeve | Numri gjobave mandator te pa paguara | Numri i përjashtimeve nga komunikacioni | Numri i aksioneve me Policinë e Kosovës | Numri i aksioneve me Inspektoren e Ministrisë së Infrastrukturës | Numri reklamave të konfiskuara | Numri i kërkesave të pranuara | Numri i kërkesave të shqyrtuara |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali** | 903 | 454 | 58 | 04 | 61 | 32 | 08 | 15 | 43 | 43 |
| | | | | | | | | | | |

## 5. STATUSI I LENDEVE NE PROCEDURE ADMINISTRATIVE

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim në procedurë administrative ka shqyrtuar një numër të kërkesave dhe atë konform LPA dhe sistemit unik të përcaktuar nga MAPL për administratën komunale brenda afatit ligjor janë trajtuar këto lëndë si në tabelë:

| | |
|---|---|
| Të miratuara | **1142** |
| Të refuzuara | 0 |
| Të pezulluara | 1 |
| Të hedhura poshtë | 0 |
| Në proces të shqyrtimit | **8** |
| pranuara gjithsej-Zgjidhur | **1451** |

- **PROJEKTET TJERA – që janë realizuar bashkëpunim me zyrën e prokurorimit e të cilat tash e tutje me ndërrimin e statutit janë kompetenca të DSHPIB :**

| Nr. | Emërtimi i rrugës | Në realizim | E realizuar | Vlera totale |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Asfaltimi i rrugës në lagjen e Zabelit Sahit Agës | | E përfunduar | 220,099.36 € |
| 2 | Rrënimi i objektit të vjetër të shkollës dhe largimi i deponive të egra në fshatin Velekincë | | E përfunduar | 9,677€ |
| 3 | Asfaltimi i rrugëve krahu kah Deponia e qytetit | | E përfunduar | 54,777.20€ |
| 4 | Asfaltimi i rrugës Përlepnicë – Vali Ranxh | | E përfunduar | 245,825.89€ |
| 5 | Asfaltimi i rrugës Gjilan Bujanovcë – Bateria | në realizimi | | 896,274.83 € |
| 6 | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shillovë | në realizimi | | 35,454.33 € |
| 7 | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Zhegër | | E përfunduar | 95,512.34€ |
| 8 | Asfaltimi i rrugëve në lagjen nr.VIII " Motrat Qiriazi dhe Hasan Tasini" | | E përfunduar | 87,567.41€ |
| 9 | Asfaltimi i rrugës " Mulla Idrizi" | në realizim | | 105,805.20€ |
| 10 | Asfaltimi i rrugëve në lagjen Arbëria | në realizim | | 43,740.50 € |
| 11 | Asfaltimi rrugëve në lagjen " Muharrem Kurteshi " | në realizim | | 99,825.40€ |
| 12 | Asfaltimi i rrugëve " Rukije Haliti dhe Vëllëzërit Llozana " | | E përfunduar | 93,120.12 € |
| 13 | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Doberqan | | E përfunduar | 50,177.00€ |
| | Asfaltimi i rrugëve në fshatin Livoq I Ulët | | E përfunduar | 29,733.30€ |
| 14 | Hapja dhe trasimi i rrugëve sipas planeve Rregullimi i varrezave te kodra e dëshmorëve | | E përfunduar | 55,629.18€ |

**Projektet e kanalizimeve :**

| Nr. | Projektet e kanalizimeve | Ne realizim | E realizuar | Vlera totale |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Rregullimi i kanalizimit fekale dhe atmosferik në rrugën Gjilan | | E përfunduar | 65,757.29€ |
| 2 | Rregullimi i kanalizimit fekale në fshatin Dobërqan | | E përfunduar | 9,788.50€ |
| 3 | Rregullimi i kanalizimit atmosferik në rrugën 15 qershori | | E përfunduar | 45,059.42 € |
| 4 | Rregullimi i kanalizimit fekale në lagjen te Vishnjet | | E përfunduar | 39,708.33 € |

- **SFIDAT E DREJTORISE PER VITIN 2015**

**a.** Shqetësuese kanë qenë reshjet e shumta të cilat kanë shkaktuar vërshime disa herë në qytet dhe fshatra. Vërshimet kanë ardhur si pasojë e gjendjes jo të mirë të shtretërve të lumenjve (hudhja e mbeturinave, devijimet, ndërtimet pa kritere në brigjet e lumenjëve), zënja e kanaleve anësore të rrugëve, ujëlëshesave, mungesa e kolektorëve kryesorë të rrjetit të kanalizimit fekal , mungesa e rrjetit të kanalizimit atmosferik etj. Kemi qenë vazhdimisht në kontakt me DMSH (drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim), KRU "Hidromorava" dhe të gjithë faktorët tjerë relevant në tejkalimin e kësaj gjendje.

**b.** Pastrimi i shtretërve të lumenjëve dhe mirëmbajtja vijave ujore dhe infrastrukturës përcjellëse të tyre mbetet prioritet;

**c.** Caktimi i lokacionit të ri të varrezave të qytetit, ju ka dërguar kërkesë urgjente (DUMM)

**d.** Ndërtimi i kolektorëve të ujërave fekale në qytet dhe fshatra duke përfshi edhe impiantin për trajtim të ujerave të zeza;

**e.** Zbatimi i planit të mobilitetit në trafik ;

**f.** Numri i madh i taksive me leje e posaçërisht i atyre pa leje;

**g.** Caktimi i lokacionit dhe rregullimi i tregut te kafsheve,

**h.** Caktimi i lokacionit dhe rregullimi i tregut të druve dhe rërës;

**i.** Ndërtimi i autoparkut- për vendosjen e makinave te aksidentuara dhe tjerat që tërhiqen për shkak te parkingut të gabuar, veprave penale

**j.** **Për realizimin e kërkesave të qytetarëve, ngritjen e shkallës së ofrimit të shërbimeve ndaj tyre si dhe realizimin e gjitha projekteve që ka planifikuar DSHPIB-ja kërkojmë që të ndahet mjete shtesë.**

**Me respekt**,